



# Bashkia Shijak

## Buxheti për Qytetarin Plani 2022 - 2024



Dokumenti bazohet në buxhetin e miratuar për vitin 2022 dhe programin buxhetor për periudhën 2022-2024 të cilat janë pjesë e Planit të performancës 2022 - 2024 të bashkisë Shijak.

<https://public.tableau.com/app/profile/loren5044/viz/Shijak-PlaniiPerformancs2022-2024/TeArdhurat#1>

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Shijak me mbështetjen e Projektit Bashki të Forta dhe Kompania e konsulencës Shapo Consulting.

## Përmbajtja

<b>Fjalor shpjegues .....</b>	<b>3</b>
<b>Të dhëna të përgjithshme .....</b>	<b>4</b>
<b>Cfarë është buxheti për qytetarin.....</b>	<b>5</b>
<b>Nga vijnë paratë .....</b>	<b>5</b>
<b>Ku shkojnë paratë.....</b>	<b>7</b>
<b>Shpenzimet buxhetore .....</b>	<b>8</b>
<b>Investimet.....</b>	<b>9</b>
<b>Administrimi i bashkisë.....</b>	<b>11</b>
<b>Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.....</b>	<b>13</b>
<b>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....</b>	<b>15</b>
<b>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....</b>	<b>17</b>
<b>Ndërgjegjësimi mjedisor .....</b>	<b>20</b>
<b>Rrjeti rrugor rural .....</b>	<b>21</b>
<b>Funizimi me ujë.....</b>	<b>24</b>

# Fjalor shpjegues

## Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

## Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

## Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

## Transferrat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

## Transferrat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

## Transferrat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

## Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

## Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

**Tregues të performancës së programeve buxhetore.** Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuencimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

## Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion




## Të dhëna të përgjithshme

### Bashkia Shijak

Popullsia  
**27,861**

**4** Njësi

Sipërfaqe  
**92.24 km<sup>2</sup>**



Bashkia Shijak e pozicionuar në qendër të vendit përbëhet nga 4 Njësi Administrative (Manëz, Maminas, Shijak, Gjepalaj) me sipërfaqe prej 92,19 km<sup>2</sup>. Sipas Censusit të vitit 2011, Shijaku ka 27,861 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 44,103 banorë. Ka një densitet prej 302 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censusit 2011, nga të cilët 74% e saj në zonën rurale dhe 16% në zonën urbane. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Shijakut.

Bashkia ka rreth 7,000 familje, me një raport gjinor 49% femra dhe 51% meshkuj.

Rrjeti rrugor prej 163 km linear shtrihet në rreth 35 km në pjesën urbane të saj.

Bashkia ka rreth 290 punonjës dhe drejtohet nga Kryetari **Elton Arbana**.

Zhvillimi i përgjithshëm i bashkisë mbështetet në dy drejtime kryesore:

- ✘ Bujqësia dhe industria fasonë
- ✘ Agroturizëm

*Bashkia si gjithë pjesa tjetër e vendit ka ndjerë efektet e pandemisë botërore. Fokusi për tre vitet e ardhshme mbetet:*

- ✘ Mbrojtja e shtresave në nevojë
- ✘ Mbështetjen e biznesit për të kapërcyer efektet e pandemisë

## Cfarë është buxheti për qytetarin

Buxheti për qytetarin promovon aksesin publik në infomacionin buxhetor dhe ndihmon në miratimin e një buxheti të përgjegjshëm. Është konceptuar në mënyrë të thjeshtë për të shpjeguar sesi bashkia grumbullon, shpërndan dhe shpenzon paratë e tatimpaguesve.

Ky dokument tregon se çfarë ofron buxheti jo vetëm në shifra financiare por edhe se çfarë shërbimesh i ofrohen qytetarëve dhe cila është performanca e planifikuar për tre vitet e ardhshme.

Në këtë dokument janë paraqitur vetëm ato shërbime që zënë peshën më të madhe në buxhetin e bashkisë dhe ato që kanë rritjen më të madhe për vitin 2022 kundrejt vitit 2021.

## Nga vijnë paratë


### Burimet kryesore



Më poshtë burimet e shpërndarjes së parave do të vijnë në formë më të detajuar me taksa, të ardhura dhe tepricat që mbartim nga viti i shkuar. Rritja në totalin e burimeve të financimit reflekton rritjen e kontributit të transfertës së kushtëzuar të qeverisë qendrore krahasimisht me vitin 2021 për projektet e ujit të pijshëm. Në tërësi të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë prej taksave, tarifave vendore janë parashikuar me rritje për vitin 2022 me rreth 38% dhe tre vitet e ardhshme kundrejt vitit 2021 (rritje me rreth 20%).

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (000 Lekë)	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Ndryshimi në % 2022 vs 2021
	<b>704,615</b>	<b>976,276</b>	<b>997,534</b>	<b>1,945,693</b>	<b>1,366,845</b>	<b>1,254,002</b>	<b>95%</b>

Kategoria	Burimi buxhetor							
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	11,608	18,322	11,857	16,515	17,122	17,760	21%
	Të ardhura nga taksat lokale	129,687	104,574	166,224	200,970	159,105	160,382	39%
	Të ardhura nga tarifa vendore	20,844	28,396	39,511	62,246	62,993	66,695	58%
	Të ardhurat e tjera	2,665	4,878	13,346	40,000	14,715	15,521	200%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	277,122	356,074	512,378	1,390,001	873,381	744,196	171%
	Transferta e pakushtëzuar	130,451	134,908	147,139	141,939	145,506	155,425	-4%
	Trasferta specifike	61,948	62,815	67,079	94,022	94,022	94,022	40%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti i kaluar	20,000	40,000	0		0	0	



## Ku shkojnë paratë



## Dy fjalë mbi shpenzimet


Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 planifikohet të dyfishohen (rriten me rreth 94%) kundrejt vitit 2021. Shërbimet më të financuara të bashkisë janë: kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara; rrjeti rrugor; arsimi bazë dhe parashkollori dhe mbrojtja e mjedisit.

Dukshëm buxheti i vitit të ardhshëm është buxheti i mbështetjes së rrjetit vaditës dhe kullues, trashëgimisë kulturore, menaxhimit të mbetjeve, arsimit bazë dhe parashkollorit, familjes dhe fëmijëve shërbime këto që kanë rritjen më të madhe kundrejt vitit 2021.

**SHPENZIMET**  
(Në mijë Lekë)

Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Ndryshimi në %
<b>644,237</b>	<b>913,232</b>	<b>997,533</b>	<b>1,935,535</b>	<b>1,366,845</b>	<b>1,254,002</b>	<b>94%</b>

## Shpenzimet buxhetore



**Buxheti për vitin 2022 rritet me rreth 94% kundrejt vitit 2021 duke reflektuar kështu rritjen në burimet e financimit (projektet me financim të qeverisë dhe rritja e të ardhurave nga taksat vendore).**

**Trashëgimia kulturore dhe vaditja-kullimi kanë rritjen më të madhe në buxhetin e vitit të ardhshëm kundrejt vitit 2021. Një buxhet në rritje reflektohet në rritjen e financimit në pothuajse gjithë shërbimet e tjera.**







# Investimet

Cilat janë programet që kanë  
përfituar më tepër

## INVESTIME



INVESTIMET (Në mijë Lekë)	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
	412,984	444,488	1,328,279	770,400	649,477



## Dy fjalë mbi rezultatin e investimeve

Bashkia synon të investojë për përmirësimin e shërbimeve publike një fond mbi 1.33 miliardë Lekë në vitin 2022. Kundrejt vitit 2021 investimet janë rritur me rreth 35%. Kujtojmë që viti 2021 ashtu sikurse edhe viti 2020 ishin vite të jashtëzakonshme për shkak të mbështetjes nga ana e Qeverisë qendrore për projektet e rindërtimit.

Për vitin e ardhshëm pesha e investimeve pritet të arrijë rreth 69% të totalit të shpenzimeve buxhetore dhe 31% shpenzime korente (paga; shpenzime për mirëmbajtje dhe operimi) duke ndryshuar tërësisht strukturën e shpenzimeve të bashkisë. Për herë të parë në historinë e buxhetit të bashkisë Shijak investimet tejkalojnë shpenzimet korente.

Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: vaditje – kullim, furnizimi me ujë të pijshëm, ndërtimi i pallatit të kulturës, rehabilitimi dhe rivitalizimi i lumit Erzen, projekte asfaltimi rrugësh etj.

# Administrimi i bashkisë

	<b>Vlera në mijë Lekë</b>	<b>Pesha ndaj Buxhetit në %</b>	<b>Ndryshimi 2022 vs 21</b>
<b>Plani 2022</b>	<b>94,228</b>	<b>5%</b>	<b>-16%</b>



## Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Figura 1: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
➔	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)	0	0	0	0	0	0
➔	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	4.17	0.7	0	0	0	0
○	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)		0.62				

Produkte	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plani 2024
Ditë trajnimi në total		21	22	25	30	30
Numri total i personave të trajnuar		34				
Femra		22				
Meshkuj		8				

Të dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	2022 Plan	Plan 2023	Plan 2024
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	11	2	0	0	0	0
Femra						
Meshkuj						
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	0	0	0	0	0	0
Numri total i punonjësve të bashkisë	312	312	312	312	312	312
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	75	75	75	75	75	75
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	237	237	237	237	237	237
Shpenzime për investime (Në mijë lekë)	11,643	175,032	7,966	0	175,032	0

Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë (Në mijë lekë)	181,999	190,944	197,994	216,054	216,295	217,025
Shpenzime korente (Në mijë lekë)	70,234	88,204	104,100	94,228	84,550	86,850

INVESTIME	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Administrimi i bashkisë</b>	<b>175,032</b>	<b>7,966</b>	<b>0</b>	<b>175,032</b>	<b>0</b>
<b>Në mijë lekë</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>					
Asistence teknike per pasuri e paluajtshme ne funksion te ligjit 7501 dhe rregjistri e l-re ne zona te vecanta		4,860			
Blerje PC dhe Kondicioner		1,966			
Ndertim Bashkie e re Shijak				175,032	
Rikonstrukcion i Zyrave Gjepalaj					

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon të realizojë shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në shumën rreth 94 milionë lekë. Administrata zë rreth 5% të buxhetit të bashkisë. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën përgjithshësisht janë të pakta. Në vitin 2022 ato janë fare modeste krahasuar me vitin 2021. Administrata e bashkisë synon të përmirësojë performancën e saj gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Përmirësimin e respektimit të kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës
- ✿ Rritjen e kapaciteteve profesionale të administratës. Rritje e numri mesatar të ditëve të trajnimit për një punonjës
- ✿ Punonjësit nuk do të lëvizin nga puna duke sjellë qëndrueshmëri të administratës.

# Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj Buxhetit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	179,000	9%	-4%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 2: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuar  
Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar.

## Trendi

Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri shërbimeve të ofruara për persona PAK në shtëpi (Ndryshimi vjetor në numer)	-2	2	0	0	0	0
Perfitimi monetar (në mije lekë) për persona të sëmurë dhe PAK	101.74	101.5	113.6	109.3	109.0	109.3
Persona me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	0	0	0



<b>Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti</b> (Ndryshimi vjetor në numer)	10	4	0	0	0	0
---	----	---	---	---	---	---

<b>Produkte</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plani 2024</b>
<b>Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti:</b>	1,634	1,656	1,656	1,656	1,656	1,656
Femra	712	763	763	763	763	763
Meshkuj	922	893	893	893	893	893
<b>Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje</b>	0	2	2	2	2	2

### Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për mbështetje monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht ose plotësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.) në shumën rreth 179 milionë lekë. Bashkia shpenzon rreth 9% të buxhetit për këtë shërbim. Bashkia synon të përmirësojë performancën e saj në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Duke mbështetur personat të cilët kanë marrë statusin PAK të cilat janë identifikuar dhe bërë pjesë e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mirëqënies sociale
- ✿ Rritjen e numrit të shërbimeve që i ofrohen në shtëpi personave PAK

# Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Plani 2022	Vlera në mijë Lekë <b>89,132</b>	Pesha ndaj buxhetit në % <b>5%</b>	Ndryshimi 2022 vs 21 <b>21%</b>
------------	-------------------------------------	---------------------------------------	------------------------------------

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi baze dhe parashkollori: korente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
→	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	40.10	29	35	35	35	35
→	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	19.88	14	13	13	13	13
↑	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)	8,169	9,336	5,267	6,367	5,156	5,345

<b>Produkte</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	119.0	119.0	161	161	161	161
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor			48			
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	16	14	14	14	14	14

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	621	612	575	575	575	575
Femra		297	276	276	276	276
Meshkuj		315	299	299	299	299
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç						
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç						
Mësues në sistemin parashkollor		22	22	22	22	22
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	59	59	59	59	59	59
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	2,366	1,684	2,081	2,081	2,081	2,081
Femra		793				
Meshkuj		891				
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë (Në mijë lekë)	130,706	130,706	73,736	89,132	72,182	74,832

### **Dy fjalë mbi performancën e shërbimit**

- ✿ Bashkia planifikon shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në shumën rreth 89 milion lekë për vitin 2022. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë vitit të kaluar edhe atij që po mbyllim bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 5% të buxhetit të saj. Për vitin 2022 buxheti do të rritet me rreth 21%, kjo për shkak edhe të disa investimeve që parashikohen në këtë sektor. Bashkia synon të përmirësojë performancën e saj në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:
- ✿ Ruajtjen e nivelit të frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Ruajtjen e normës mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✿ Uljen e kostos së një institucioni arsimor duke përmirësuar eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim
- ✿ Investimet synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve.



INVESTIMET	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Ne mije leke</b>					
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	59,361	13,450	13,450	0	0
<b>Emërtimi i Projektit</b>					
F.V Materiale per rrjetin e Ujesjelles Gjepalaj					
Ndertim i Shkolles Adem Sabli Borake /NJA Xhafzotaj	52,211				
Pjesemarrje ne investim 10 % rindertim i Shk " Adem Sabli "		7,150			
Rindertim i Shkolles M. Dollaku					

## Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	646,106	33%	3964%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit: korrente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e prodhimit bujqësor dhe aktivitetit të fermerëve nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës sekondare dhe terciare të kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
○	Kilometra linear kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (Raporti në %)		26				
○	Kilometra linear kanal ujitës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (Raporti në %)		18				
○	Kosto mesatare për 1 km linear kanal ujitës dhe kullues të menaxhuar (Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim kundrejt kilometrave total te sistemit ujites dhe kullues Mije Lekë/për km)		0				
➔	Numri i familjeve përfituese të shërbimit të vaditjes dhe kullimit (Ndryshimi vjetor në numër)	0.00	4,562	-4,562	0	0	0
➔	Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (Ndryshimi vjetor në ha)	0.00	0	0	0	0	0
➔	Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivuar kundërjet totalit të tokës bujqësore (Raporti në %)	57.59	58	58	58	58	58

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për ndërtimin dhe organizimin e sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, menaxhimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, nën përgjegjësinë e bashkinë në të gjitha njësitë administrative të saj në shumën 646 milionë lekë për vitin 2022 nga të cilat 98% e fondit do të shkojë për investime. Bashkia do të shpenzojë rreth 33% të buxhetit të saj për këtë shërbim duhe e disafishuar buxhetin për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në sistemin e kanaleve kulluese dhe vaditëse do të përmirësojnë performancën në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✿ Bërjen funksionale të kanaleve kulluese dhe vaditëse – pastrimin e mëtejshëm të tyre
- ✿ Rritjen e sipërfaqes bujqësore të mbuluar me shërbimin e vaditjes dhe kullimit
- ✿ Uljen e koston së pastrimit të një kilometri linear kanal kullues dhe vaditës duke rritur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim të ofruar nga bashkia.

<b>Produkte</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje Në Ha	1,484	1,484	0	0	0	0
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim Në Ha	6,710	6,710	6,710	6,710	6,710	6,710
Familje përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	0	4,562	0	0	0	0
Kanal kullues i pastruar Në km linear	0	14	0	0	0	0
Kanal ujitës i pastruar Në km linear	0	9	0	0	0	0
Sipërfaqe e tokës së kultivuar Në Ha	3,864	3,864	3,864	3,864	3,864	3,864

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Buxheti i shpenzuar për ujitje dhe kullim (total shpenzime) Në mijë lekë			15,898	646,106	11,300	11,300
Shpenzimet për investime Në mijë lekë						
Sistemi kullues Në km linear		52				
Sistemi ujitës Në km linear		52				
Sipërfaqe e tokës bujqësore Në Ha	6,710	6,710	6,710	6,710	6,710	6,710

<b>INVESTIMET</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
<b>Ne mije leke</b>					
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	<b>0</b>	<b>4,860</b>	<b>634,327</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Rehabilitim i Lumit ERZEN/ NjA Shijak			157,138		
Rivitalizim i Lumit Erzen/ NjA Shijak			95,825		

# Ndërgjegjësimi mjedisor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	252,962	13%	disa herë rritje

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Ndërgjegjësimi mjedisor: korente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për administrimin, kordinimin dhe monitorimin e politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore; prodhimin dhe përhapjen e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor; identifikimin, kontrollin dhe menaxhimin e burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në shumën 253 milionë lekë për vitin 2022 të gjitha 80% do të shkojnë për investime. Bashkia do të shpenzojë rreth 13% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor do të përmirësojnë performancën në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✧ Përmirësimin e cilësisë së mjedisit ;
- ✧ Mirëmenaxhim i burimeve ujore

## Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	238,880	12%	-3%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korentë dhe investime

### Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Raporti i rugeve te asfaltuara ndaj totalit te rugeve (te asfaltuara, cakull etj) ne %		17	17	17	17	17

→	<b>Rrjeti rrugor</b> (ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
→	<b>Rrugë rurale</b> (rrjeti rural ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
→	<b>Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit</b> (ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
→	<b>Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit</b> (ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
→	<b>Rrugë urbane</b> (rrjeti urban ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
→	<b>Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit</b> (ndryshimi vjetor në km linear)		0	0	0	0	0
↑	<b>Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane</b>	347	995	1,518	1,466	3,157	1,839

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në shumën 239 milionë lekë për vitin 2022 nga të cilat 85% e fondit do të shkojë për investime. Bashkia do të shpenzojë rreth 12% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor do të përmirësojnë performancën në këtë shërbim gjatë vitit 2022 e në tre vitet e ardhshme duke u reflektuar në:

- ✱ Uljen e aksidenteve rrugore;
- ✱ Cilësinë e gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural te bashkisë

<b>Produkte</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
<b>Km rrugë të mirëmbajtura në vit</b>	163.0	163.0	163.0	163.0	163.0	163.0
<b>Rrugë rurale të mirëmbajtura në km linear</b>	128.0	128.0	128.0	128.0	128.0	128.0
<b>Rrugë urbane të mirëmbajtura në km linear</b>	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0
<b>Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit</b>	27	27	27	27	27	27
<b>Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara në km linear</b>		27.0	27.0	27.0	27.0	27.0
<b>Rrugë urbane të asfaltuara në km linear</b>		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
<b>Rrjeti rrugor në km linear (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)</b>	163	163	163	163	163	163

Rrjeti rrugor rural në km linear	128	128	128	128	128	128
Rrjeti rrugor urban në km linear	35	35	35	35	35	35
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në Lekë:	56,491	162,266	247,502	238,880	514,528	299,725
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin rural		15,680	52,000	50,194	53,973	13,747
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin urban		146,586	33,208	10,050	16,020	51,776

<b>INVESTIMET</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
<b>Rrjeti rrugor rural</b>	<b>134,166</b>	<b>217,421</b>	<b>203,380</b>	<b>479,128</b>	<b>264,775</b>
<b>Në mijë lekë</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Pjesëmarrje ne investim 10 % rindertim i Shk " M. Dollaku "		6,300			
Rik. Sis. Asf Lagjja e Keceve/ NjA Shijak		16,208	11,050	21,698	
Rik. Sis. Asf rruga Auto Cizmeli - Shetel /NjA Gjepalaj		50,961			
Rik. Sis. Asf rruga Auto Eminas i Vogel /NjA Gjepalaj				92,268	18,793
Rik. Sis. Asf rruga Auto KENETE/NjA Gjepalaj			22,661		
Rik. Sis. Asf rruga Bio ferma Rremilli- Qender Likesh /NjA Gjepalaj					36,208
Rik. Sis. Asf rruga Lagje e re BODINAK/ NjA Maminas				64,008	
Rik. Sis. Asf rruga Lagje e re Metallaj/ NjA Maminas			35,840		17,903
Rik. Sis. Asf rruga RRUBJEKE/ NjA Maminas		20,000	20,000	25,142	5,000
Rik. Sis. Rruga Petrit Dedja / NjA Xhafzotaj					30,827
Rikualifikimi rruges Ish SMT deri te Shala Group dhe ndertimi i rrjetit KUZ ne Rugen " Xhelal Memoci	12,680	32,000	23,194	22,935	9,115
Ruge te brendsh shijak sheshi Naim Frasheri		27,000			51,408
Ruge te brendshme ne fshatin Ardhishte				252,232	
Shpronësime publike		8,362			
Rrjeti i 4 urave					74,163

# Funizimi me ujë

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Ndryshimi 2022 vs 21
Plani 2022	132,059	7%	-25%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Funizimi me ujë: korente dhe investime

## Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

### Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Orë ujë në ditë (Ndryshimi vjetor në orë)	3.2	0.2	0.5	0.5	0.5	0
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)		82	82	82	82	82



## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia planifikon shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e pëprballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në shumën 132 milionë lekë për vitin 2022. Bashkia shpenzon rreth 7% të të gjithë buxhetit për këtë shërbim. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitetet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë. Aktualisht uji i pijshëm ofrohet nga UK Durrës ndërkohë që bashkia paguan ujin me shumicë nga kjo ndërmarrje publike. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritjen e mbulimit me ujë të pijshëm të familjeve dhe bizneseve të cilat nuk e aksesojnë këtë shërbim deri më sot
- ✿ Më shumë territor është mbuluar me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✿ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✿ Mbulimi i koston së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifat e shërbimit.

Duke qenë se ky është një shërbim në zgjerim bashkia do të mbledhë dhe raportoje të dhëna për sa më sipër.

<b>Produkte</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	38,537	38,537	38,537	38,537	38,537	38,537
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm	8.3	8.5	9	9.5	10	10

<b>Të dhëna</b>	<b>Fakt 2019</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Popullsia totale e bashkisë	46,996	46,996	46,996	46,996	46,996	46,996
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm						
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm						
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi)						

<b>INVESTIMET</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
<b>Ujësjetllës Kanalizime</b>	<b>0</b>	<b>170,865</b>	<b>128,269</b>	<b>20,000</b>	<b>0</b>
<b>Në mijë lekë</b>					
<b>Emërtimi i Projektit</b>	<b>Fakt 2020</b>	<b>Plan 2021</b>	<b>Plan 2022</b>	<b>Plan 2023</b>	<b>Plan 2024</b>
Ndërtim i Rrjetit të Ujësjetllës në qytetin e Shijakut	70,866	170,865	108,269		
Rikonstruksion i tubacionit nga mbikalimi i Vores deri në Depo Shijak "Rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas, Karec, Bilalas, Karpen, Bodinak Loti I"		50,000	20,000	20,000	
Riparim i rrjetit Ujësjetllës/ NjA Shijak					
Ujësjetllësi Likëshe					